

Zamir TAFILICA\*

## HARTA ARKEOLOGJIKE E RAJONIT LINDOR TË LIQENIT TË SHKODRËS

**Përmbledhje:** Artikulli përmban të gjitha sitet arkeologjike, varrezat, kështjellat, kishat e monumentet e tjera, të cilat janë evidentuar apo gërmuar e studjuar deri më sot në rajonin lindor të Liqenit të Shkodrës. Ato janë renditur sipas kriterit kronologjik, duke i ndarë në tri epoka: prehistorike, antike e mesjetare. Periudha prehistorike karakterizohet nga numri i madh i tumave, që datojnë që nga bronzi i hershëm dhe vendbanimet e shumta të fortifikuara, të vendosur në kodrat përreth pellgut të Shkodrës. Për periudhën helenistike konstatohet një përpjekje këmbëngulëse e mbretërisë ilire për tu mbrojtur nga kërcënimi i përhershëm i Romës përmes ndërtimeve të fuqishme mbrojtëse, kurse për periudhën romake vërehet popullimi i dendur tashmë edhe i zonës fushore, dhe një jetë e gjallë urbane. Mesjeta përfaqësohet nga kështjella, varreza e kisha të shumta të shpërndara në të gjithë territorin, por në një gjendje mjaft të shkatërruar. Ato dëshmojnë kristianizimin e hershëm të rajonit, ruralizimin e jetës, faza zhvillimesh të qeta, por dhe shkatërrimesh të mëdha, si pasojë e luftërave e konflikteve të herëpashershme.

**Fjalë kyçe:** *rajoni lindor i Liqenit të Shkodrës, sitet arkeologjike, varrezat, kështjellat, kishat, Mbretëria Ilire*

**Abstract:** The article includes information about all the archeological sites, graves, castles, churches and other monuments which are discovered, evidenced and studied on the Eastern Region of Shkodra Lake. According to the chronological order, they are divided into three epochs: prehistoric, antic and medieval. The prehistoric period is characterized by the great number of tumulus which date back since the early bronze and numerous fortified settlements located in the hills around Shkodra basin. For the Hellenistic period we find a persistent effort of the Ilirian Kingdom to be protected by the permanent threat of Rome by building strong protective buildings, meanwhile during the Roman period we notice a dense population even in the field area and a lively urban live. The Medieval period is represented by castles, graves and numerous churches scattered throughout the territory, but not in a very good condition. They show the early Christianization of the region, life ruralization, quite phases of development but at the same time as a result of occasional wars and conflicts, great destructions.

**Key words:** *Eastern Region of Shkodra Lake, archeological sites, graves, castles, churches, Ilirian Kingdom*

---

\* Zamir Tafilica, Muzeu Historik i Shkodrës, Sektori i Arkeologjisë




Figura 1. Harta arkeologjike e Rajonit Lindor të Liqenit të Shkodrës

Gjurmimet dhe studimet e vazhdueshme arkeologjike në rajonin lindor të Liqenit të Shkodrës tashmë kanë evidentuar dhe kanë nxjerrë në dritë një në numër të konsiderueshëm sitesh e monumentesh arkeologjike të periudhave të ndryshme historike (Fig. 1).

Në një tarracë pranë shpellës së Gajtanit, 7 km larg Shkodrës, janë gjetur mbi sipërfaqe materiale interesante paleolitikë. Janë disa vegla pune prej stralli të punuara sipas teknikave të tipit *Lëvalua*, prodhime tipike të industrisë musteriane që i takojnë Paleolitit të Mesëm, periudhës së ndërkullimit të fundit Ris-Vyrm. Shfaqja e gjurmëve të epokës së gurit të latuar në këtë zonë të ultësirës shkodrane nuk është e papritur, pasi po këtij areali i përkasin gjetjet litike të Crvena Stijenës në Mal të Zi (Fistani, 1989; Korkuti, 1989).

Pranë fshatit Gajtan, në një lugth mes dy majash të një kodre ndodhet një shesh që rrethohet nga një mur mbrojtës i ruajtur më mirë në anën juglindore, në një gjatësi prej 90 m. Në gjendjen e sotme ky trakt ruhet në lartësi prej 2.40 m. dhe ka një gjerësi prej 3.50 m. Gurët përbëhen prej blloqesh të mëdhenj të papunuar ose pak të latuar, të lidhur në të thatë. Këtë mur e përshkon një portë 1.80 m. e gjerë. Një ekspeditë arkeologjike konstatoi katër shtresa kulturore, ndër të cilat më e hershmja (*Gajtan I*), me trashësi prej 2.10 m. përmbante copëra enësh e suvaje balte me gjurmë thuprash, gurë stralli të vegjël, fragment sèpate guri dhe eshtra kafshësh të ndryshme. Kjo shtresë daton në periudhën e hershme të bronzit. Shtresa e dytë (*Gajtan II*) me trashësi 0.70 m. lidhet me periudhën më intensive të jetës së vendbanimit. U zbuluan një tok furrash dhe urnash prej balte, brenda të cilave u gjetën eshtra fëmijësh, si dhe fragmente të shumta qeramike tipike ilire, sèpata e mokra prej guri etj. Me këtë shtresë, që daton në periudhën e parë të hekurit, lidhet dhe muri mbrojtës i vendbanimit (Islami & Ceka, 1965; Korkuti, 1972).

### *Prehistoria*

Vendbanimi i Ganjollës ruhen sipër një kodre të lartë shkëmbore mbi fshatin homonim, 8 km nga Shkodra. Në gjurmimet e vitit 1988 u fiksua një shtresë kulturore e përzier me pak fragmente të bronzit të hershëm e më shumë të shek. II-I p. k. Ndërkohë u evidentuan dhe dy trakte muresh fortifikuese me tipologji të ndryshme, në drejtimin verior e lindor. Trakti i parë (*Ganjollë I*), ai i krahut verior, ngrihet direkt mbi taban me gurë gëlqerorë të vegjël e mesatarë, lidhur në të thatë. Muri ka gjatësi 140 m., gjerësi 4 m. dhe ruhet deri në lartësinë 1.70 m. Tipologjia e murit dhe prania e qeramikës së bronzit të hershëm janë elementë të mjaftueshëm për një datim në këtë periudhë, krahas Gajtani I, Shkodër I a, Shtojit dhe Shkrelit. Ky vendbanim i fortifikuar, pas një heshtje të gjatë, pati një tjetër fazë jete në shek. II-I p. k. (Lahi, 1993).

Vendbanimi i fortifikuar i Beltojës, me sipërfaqe 0.8, ha., ndodhet rreth 2 km në vijë ajrore në jug të Kalasë së Shkodrës, mbi një kodër shkëmbore. Fortifikimi përfaqësohet nga dy trakte muresh, që, nisur nga tipologjia e tyre, duhen lidhur respektivisht me dy shtresat kulturore koresponduese. Muri primitiv (*Beltojë I*) me gjerësi 3.50 m. që ndodhet në anën verilindore, ruhet në gjatësinë 20 m. Ai është ndërtuar në të thatë, me blloqe gurësh të papunuar të mëdhenj e mesatarë. Gjurmimi i 1987-

ës evidentoi dy shtresa kulturore: Shtresa e parë, që lidhet me traktin e mësipërm, e vendosur drejt mbi taban, përmbante fragmente enësh e copa balte me gjurmë të thuprave. Kjo lëndë përfaqëson periudhën e parë të jetës dhe daton në fundin e epokës së bronzit e fillimin e asaj të hekurit (Lahi, 1988).

Për të ndjekur origjinën dhe rrugën e zhvillimit të jetës së saj nga aspekti arkeologjik, në vitin 1984 në Shkodër, në kodrën, ku ngrihet kalaja „Rozafa” filluan disa gërmime hetimi. Gërmimet në sektorin A, në oborrin e parë të kalasë doli në dritë një shtresë kulturore me dy horizonte banimi, që u përkasin dy fazave të ndryshme të jetës në vendbanim gjatë periudhës së bronzit të hershëm (*Shkodër Ia* dhe *Shkodër Ib*). Faza e parë ka lidhje të shumta me fazat përkatëse në Qytezën e Gajtanit e në shpellën e Nezirit (Kukës) dhe pjesërisht me materialet e bronzit të hershëm në tumat e Shkrelit e në ato të Shtojit. Në fazën e dytë afërsitë kulturore me horizontin e dytë të bronzit të hershëm të Gajtanit janë shumë të mëdha (Hoxha, 1987).

Gjurmë prehistorike ka edhe në kodrën ku ndodhet kalaja e Danjës. Në anën lindore të kodrës, rreth 30 m. në jug të një kulle të rrumbullakët mesjetare, ruhet një trakt muri 3–4 m. i gjatë, i ndërtuar me gurë të papunuar, të palidhur me llaç. Muri ruhet në lartësinë e dy rreshtave gurësh. Gurët më të mëdhenj kanë një gjatësi prej 1 m. dhe lartësinë 0.60 m. Një trakt tjetër muri mesjetar, i të njëjtës teknikë ruhet në anën jugore, në një gjatësi prej 3 m. dhe në lartësinë e tri rreshtave gurësh. Ky trakt ndodhet 25 m. jashtë rrethimit të akropolit dhe prej tij ruhet vetëm faqja e jashtme (Karaiskaj, 1974).

Mbi kodrën e Kalasë së Drishtit gjurmët më të vjetra përfaqësohen nga trakte të shkëputura muresh të ndërtuar me gurë të mëdhenj të papunuar, në forma poligonale, me diametër rreth 1 m. të lidhur në të thatë. Këto mure ndodhen në bazën e mureve mesjetare dhe mund të kuptohet lehtë se kalaja e vjetër rrethonte të njëjtën sipërfaqe. Nga teknika e ndërtimit ata të kujtojnë fortifikimet e periudhës së parë të hekurit, gërmadha të të cilave ruhen edhe në rrethin e Shkodrës, si kalaja e Gajtanit, Marshejit, Ganjollës etj. (Karaiskaj, 1974).

Poshtë Maranajt, mbi një kodër shkëmbore pranë fshatit Vorfë gjendet një vendbanim i fortifikuar. Kodra ka një pjerrësi të lehtë vetëm nga ana verilindore, nga duhet të ketë qenë edhe hyrja. Sipër kodrës ndodhen disa sheshe horizontale, ku janë gjetur me shumica copëra amforash korintike të shek. V p. k. enë tryeze e amfora të shek. II-I p. k. Vendbanimi është i rrethuar nga një mur i thatë i tipit Gajtan, që qarkon jo vetëm majën e kodrës, por edhe një tarracë, duke krijuar kështu qytezën e sipërme dhe atë të poshtme. Në këtë qytezë duken edhe gjurmë muresh të lidhur me llaç gëlqereje, ndoshta të antikitetit të vonë (Jubani, 1986).

Mbi majën e kodrës „Burgu i Gorajës”, pranë fshatit Grizhë, ndodhet një vendbanim i fortifikuar ilir. Muret mbrojtëse ruhen mirë në faqen verilindore dhe në atë perëndimore të kodrës. Muret ngjajnë me ato të Gajtanit, por me një punim guri më të mirë. Në sheshin brenda mureve është mbledhur material i shek. VI-V p. k. deri në shek. II pas k. Por është gjetur gjithashtu edhe ndonjë fragment prehistorik me motiv shiritor me gropëza (Jubani, 1986).

Në kodrën e Ballezës, në grykën e luginës së Rrjollit, midis mureve të thata që ndodhen më shumë në pjesën më të lartë të kodrës, brenda akropolit, ku terreni

është edhe më i thyer, mund të dallohet një mur, që ka shumë të ngjarë t'i përkasi një ndërtimi prehistorik. Prej tij ruhet vetëm faqja e jashtme, pjesërisht gjerësia që i kalon dy metra. Gurët janë të papunuar, të vendosur njëri mbi tjetrin pa ndonjë rregull, dhe pa përdorimin e ndonjë mjeti lidhës. Muri mund të ndiqet në një distancë prej disa metrash, deri sa humbet në drejtim të lindjes, në buzën e thiktë shkëmbore të kodrës (Karaiskaj, 1974; Jubani, 1986)

Pranë fshatit Marshej ngrihet një kodër shkëmbore, që lidhet në veri me një varg kodrash të tjera, kurse rrëzë saj, nga lindja dhe juglindja kalon Përroi i Thatë, duke bërë të pakalueshme ngjitjen për në kodër. Një shesh rreth 0.5 ha mbi kodër, rrethohet në të gjitha anët nga një mur i thatë, në trajtë ledhi, duke krijuar një planimetri ekliptike. Një tjetër mur i thatë me linjë të drejtë mbyll qafën e kodrës në drejtimin perëndimor, ku pjerrësia është e vogël. Aty shtrihet një shesh i dystë me sipërfaqe rreth 1 ha. Muri rreth 90 m i gjatë ka një trashësi prej 2.70 m. dhe ruhet në lartësinë rreth 1 m. Muri përshkohet nga një hyrje e thjeshtë me gjerësi 1.60 m. Ndërtimet mbrojtëse me ledhe guri konsiderohen si tipat më të vjetra të fortifikimeve dhe i përkasin periudhës së vonë të bronzit, kurse muri i dytë konsiderohet si i njëkohshëm me Gajtananin, Beltojnë, Ganjollën, Dristin e Danjën (Karaiskaj, 1978).

Në fushën ndërmjet fshatrave Dedaj, Lohe e Zagorë shtrihet një nekropol i gjërë ilir, i përbërë prej më se 40 tumash me permasa mesatare. Ata janë kryesisht prej gurësh me pak përzjerje dheu. Në majë të tyre shihen edhe varre ciste. Në vitet 1979–1983 janë gërmuar disa tuma, të cilat ishin të ngritura mbi një varr qëndror dhe dhanë një material të bollëshëm qeramik, realizuar me teknika të ndryshme punimi e motive të shumta që i takojnë kulturës ilire Kotorac-Cetina të bronzit të hershëm (Jubani, 1983).

Një numër i konsiderueshëm tumash gjinden të shpërndara në fushën e Shtojit. Gërmimi i disa tumave konstatoi ndërtimin e tyre me gurë e me dhe, në një lartësi prej një deri në tri m. dhe me diametër nga 10 m deri në 30 m. Një unazë gurësh kufizonte perimetrin e tumulës. Në tumulën nr. 6, u zbulua varri qëndror i tipit „cist” dhe 13 varre me rrethime gurësh, që i përkasin dy periudhave: bronzit të hershëm dhe shek. VIII – VI p. k. Poshtë varrit qëndror të tumës, në një mjedis në trajtë varri të rrethuar me gurë, u gjetën 6 figurina antropomorfe prej balte. Së bashku me to u gjet edhe një enë e vogël, që të kujton qeramikën e kulturës „kotorac-cetina” të Dalmacisë, duke përforcuar kështu përcaktimin e mëparshëm të këtyre lidhjeve kulturore, të bazuar nga materialet e nekropolit të Shkrelit (Koka, 1990; Jubani, 1992).

Tuma të tjera: Në fushën e Koplikut deri në breg të Liqenit janë evidentuar deri më sot plot tuma ilire, sikurse katër tuma në fshatin Dragovojë, katër në Kosan, tri në Mokset, tri në Kosare të Gruemirës, pesë në Grizhë, një në Grudë, një në fshatin Stërbeq, katër në Grilë, një tumë në lagjen Culaj të Koplikut (Jubani, 1983).

Gjetje të rastit: Pesëmbëdhjetë sëpata prej bronzi janë gjetur rastësisht në grup ose të veçuara në pika të ndryshme të pellgut të Shkodrës: Një depo sëpatash shqiptaro-dalmate u gjet në vitin 1958 në bregun e Liqenit të Shkodrës, midis fshatit Shirokë dhe Grykës së Bunës, nën një zgavër shkëmbi. Depoja përbëhet nga 9 sëpata të shoqëruara me një fragment ene dyvegjake prej balte të pjekur, zbukuruar me vija të incizuara, që i përket fazës së parë të epokës së hershme të hekurit. Një sëpatë shqip-

taro-dalmate është gjetur në kodrën e Beltojës. Po kështu dy sëpata të këtij tipi janë gjetur në Mbishkodër në fshatin e Gradeskijes. Ata kanë të njëjtat karakteristika të sëpatave të tjera të gjetura në Shkodër dhe datojnë po në shek. X p. k.; një sëpatë „shkodrane” është gjetur në Boks të Postribës, kurse një tjetër sëpatë bronzi në Kala të Drishtit, e publikuar nga Ippen-i (Prendi, 1984; Jubani, 1983).

### *Antikiteti*

Në Labeatinë ilire lindja e jetës qytetare nis aty nga gjysma e dytë e shek. IV p. k. me themelimin e qytetit *Scodra*. Në këtë kohë pjesa e sipërme e kodrës fortifikohet me mure të fuqishmetë ngritur në të thatë me blloqe të mëdhenj guri, në stilin polygonal-trapezoidal (*moenia eacia*). Dy trakte të tilla, që i kanë shpëtuar mbulimit prej konstruksioneve fortifikuese mesjetare, dallohen në hyrje të Kështjellës. Nga fundi i viteve '70 nisin disa fushata gjermimi në sheshet e sipërme të kodrës (sek. A, B, C, D, E), ku u përfutuan një material i pasur qeramik i shek. III-II p. k. dhe i periudhës romake, ashtu edhe në qytetin e poshtëm, buzë Drinit (sek. F). ku është me interes dhe dokumentimi i disa fazave ndërtimore, të vendosura njëra mbi tjetrën, nga periudha helenistike (banesë e gjysmës II të shek. II p. k.), ajo e sundimit romak (shek. I-III pas k.), antike e vonë (shek. IV-VI pas k.) deri tek faza fundore e mesjetës së hershme (shek. XI-VIII). Gjermimet kanë nxjerrë në dritë aty pranë një mozaik polikrom me përmasa 8. 15 x 6. 44 m kompozuar me motive gjeometrike e vegjetale që i përket antikitetit të vonë. Gjermimet arkeologjike kanë zbuluar edhe një trakt të murit rrethues të qytetit të poshtëm në lagjen Alibegaj (Sek. G), ndërmjet Drinit e Bunës. Muri i zbuluar ka dy faza ndërtimi; faza e I i përkiste shek. IV pas k. dhe faza e dytë kohës së Justinianit, shek. VI pas k. (Islami, 1972; Anamali, 1986; Hoxha & Lahi, 1986; Hoxha, 2003).

Gjermimet arkeologjike të kryera në vendbanimin e *Gajtanit* treguan se jeta këtu vazhdoi deri në periudhën romake. Shtresa e katërt (*Gajtan IV*) përbante enë helenistike e romake dhe monedha të Dyrrahut, të Apolonisë, të Skodra-a e të Lisit (shek. 3–2 p. k.) Kjo shtresë që, me sa duket, është formuar nga rrëshqitje të dherave nga kurrizet e lugthit të kodrës, dëshmon banimin e vendbanimit në këtë fazë të fundit të jetës së tij (Islami & Ceka, 1965).

Trakti i dytë fortifikues (*Ganjollë II*) i vendbanimit të Ganjollës në krahun lindor të kodrës, me gjatësi 17 m. ruan vetëm faqen e jashtme të tij dhe ka një lartësi prej 1.50 m. Ruhen gjithashtu edhe gjurmët e një kulle drejtkëndëshe, në ekstremin lindor. Muri është ndërtuar sipas sistemit katërkëndësh pseudoizodomik. Fortifikimi *Ganjollë II* ka ngjashmëri tipologjike me fortifikimin *Beltojë II*. Lënda e gjetur gjatë gjermimit, tipologjia e fortifikimit dhe situatë historike në prag të luftës III iliro-romake na bën ta kërkojmë datimin në tridhjetëvjeçarin e parë të shek. II p. k., me masat mbrojtëse të Mbretit Gent (Lahi, 1993).

Muri i dytë mbrojtës (*Beltojë II*) me gjatësi 10 m. ndodhet në krahun verior të qytezës së Beltojës dhe ruan veç faqen e jashtme në lartësinë maksimale 1.40 m. Gurët e madhësive të ndryshme kanë të punuar vetëm faqet horizontale. Ky fortifikim, siç mund të kuptohet nga gurët e rënë, duhet të ketë qarkuar gjithë vendbani-

min. Teknika e punimit e afron këtë trakt muri me atë të *Ganjollës II*. Ndoshta kemi të bëjmë me një nga fortifikimet, ku, siç njofton Livi, ilirët mbështeteshin në kohërat e luftërave iliro-romake. Me këtë mur lidhet shtresa e dytë kulturore dhe daton nga gjysma e dytë e shek. III deri në shek. I p. k. (Lahi, 1988).

Në hapësirën e gjerë me një perimetër prej 2000 hapash të kodrës së *kalasë së Drishtit* shtrihet dikur akropoli i një qendër banimi i kohës romake. Aty janë gjetur herë pas here materiale të ndryshme të asaj periudhe, ndërmjet të cilave edhe një gur varri me mbishkrim latin, i përshkruar nga Th. Ippen. Përballë kodrës, ku ngrihet kalaja mesjetare, në vendin e quajtur *Muzhilë* ose *varosh*, është një tjetër vendgjetje e periudhës romake, që me sa duket duhet të ishte qyteti i poshtëm. Rrënoja banesash, gjurmë fortifikimi dhe materiale qeramike të shek. II-I p. k. duken edhe sot (Ippen, 1907).

Kodra e *Kratulit* gjendet pranë fshatit Boks të Postribës, 6 km. në verilindje të Shkodrës. në majë të një kodre shkëmbore, që vështron mbi fushën e Shtojit dhe kontrollon nga afër grykën e luginës së Kirit. Maja e kodrës, e përbërë prej një terreni të ashpër shkëmbor prej ½ ha, rrethohet prej një muri të thatë në formë elipsi, ndërtuar me blloqe të mëdhenj të punuar përgjithësisht në faqet e tyre horizontale. Gjerësia e murit është rreth 3 m. Në anën lindore muri mbrojtës është përforcuar nga një kullë katërkëndëshe kurse në drejtimin jugor ndodhet porta hyrëse me gjerësi 1.80 m. Në sipërfaqe ndeshen fragmente të pakta enësh të kohës së bronzit dhe shumë fragmente amforash të shek. II-I p. k., shek. I pas k. Për periudhën urbane, Kratuli duhet parë si një pikë kontrolli e ngritur në kuadrin e masave mbrojtëse të Gentit, përballë presionit të Romës (Fistani, 1983; Tafilica, 2010).

Afër Kratulit, majë një kodre që sheh mbi fushën e Shtojit, gjendet vendbanimi i *Vorfës*, me gjetje të shumta amforash e enësh tryeze që datojnë në shek. IV-II p. k., por nuk mungon edhe qeramika prehistorike. Ndërsa gjurmët e një muri fortifikues të lidhur me llaç gëlqereje dhe disa fragmente tjegullash e enësh dëshmojnë vazhdimësinë e jetës aty deri në antikitetin e vonë (Jubani, 1983).

Gjatë një vëzhgimi të këtyre ditëve u evidentua ndërmjet Kratulit dhe Vorfës një tjetër vendbanim kodrinor me gjurmë fortifikimi e me gjetje të konsiderueshme që kapin një hark kohor nga periudha e bronzit deri në atë romake të hershme (Tafilica, 2010).

Në bregun lindor të Liqenit të Hotit zgjatet vargu i „*Kodrave të Moksetit*”, njëra prej të cilave ka në majë një shesh të fortifikuar me mure të thatë. Në to dallohen qartë dy teknika të ndryshme punimi: njëra përbëhet prej gurësh të papunuar e me rreshta të çrregullt e tjetra prej blloqesh të mëdhenj kuadratik të puthitur mirë. Pjesa më e ruajtur e këtyre mureve ndodhet në anën Jugperëndimore të sheshit. Këtu muri ruan tre radhë gurësh që kapin lartësinë 1.40 m. Nisur nga analogjitë tipologjike me muret e *Ganjollës II*, *Beltojës II* si dhe të *Kratulit*, duket se kemi të bëjmë me një tjetër pikë kontrolli të shek. II p. k., në sistemin fortifikues të mbretërisë ilire të Gentit (Tafilica, 2009).

Në fshatin *Kalldrun* të Koplikut kanë qenë zbuluar rastësisht enë qelqi e qeramike, stela varri të shek II pas k. etj. Gërmimet e bëra aty zbuluan shtatë varre të punuar me murë gurësh zalli të lidhur me llaç. Riti i varrimit ishte ai me vendosje kufo-

me. Inventari i varreve tregon se varreza ka qenë përdorë në shek. III-IV pas k. Kjo varrezë duhet ti përkasë një vendbanimi të hapur që gjindet te „Suka e Cenit”, ku u zbuluan copa amforash të shek. II-I p. k. si dhe fragmente enësh të zbuluara me krehër të shek. IV pas k. Gjetjet e mësipërme të çojnë drejt mendimit se në rrethinën e Koplikut, ku përfshihet dhe Kalldrani, ka pasur një qendërbanim të rëndësishëm, veçanërisht në katër shekujt e parë pas k. dhe emri i parë që duhet marrë në konsideratë është *Kinna*, që përmendet në Gjeografinë e shek. II pas k. të Ptolemeut, si qytet i brendshëm i Provincës së Dalmacisë, *Sinna (Cinna)*, stacioni i parë rrugor i rrugës që nisej nga Shkodra në drejtim të Dalmacisë, që lexojmë në dy lista rrugësh, në Tabelën Peutingeriane dhe në itinerarin e Autoninit” (Anamali & Komata, 1978; Jubani, 1983; Anamali, 1986).

*Kështjella e Hotit* është ngritur mbi një kodër të pjerrët, pranë ekstremit verior të Liqenit të Hotit. Kodra me lartësi 178 m. ka në pjesën e sipërme një rrafsh, në pjesën lindore të të cilit ruhen gërmadhat e një muri rrethues në formë elipsoidale. Muret fortifikuese përforcohen nga pesë kulla katërkëndëshe. Nga muri që zbrit shpatit lindor qëndron ende më këmbë një trakt i madh me gjatësi rreth 100 m. Muret janë të punuar në të dy faqet me gurë të gdhendur dhe janë të lidhur me llaç të bollshëm gëlqereje, kurse hapësirat me gurë të vegjël të thyer. Duke u mbështetur kryesisht në veçoritë tipologjike të fortifikimit e të teknikës së ndërtimit të mureve, ndërtimi i kështjellës duhet t’i përkasë shek. VI pas k. (Prashniker & Shober, 2003).

Në malin rrëzë fshatit *Podgorë* të Koplikut, ndodhet një vendbanim i fortifikuar i periudhës së antikitetit të vonë. Në krahun perëndimor ruhen gjurmët e dy mureve me trashësi respektivisht 1.40 m dhe 0.80 m të puthitur me njëri tjetrin. Ata janë të lidhur me llaç gëlqereje dhe ruhen në lartësinë 2 m. Gjetjet, kryesisht amfora, janë të pakta dhe i përkasin shek. IV pas k. Varreza e kësaj qyteze gjendet në vendin e quajtur „Zalli i Banushit”, ku është zbuluar një varr i punuar me mure me llaç gëlqereje dhe me inventar të pasur prej enësh qelqi, fibula bronzi të shek. IV pas k. (Jubani, 1983).

### *Vendbanime të tjera të hapura*

Vendbanime të hapura janë evidentuar edhe në pika të tjera të Mbishkodrës:

a – Vendbanim i hapur në *Kosan* (top: Kiza) ku u gjetën fragmente amforash, enësh ilire.

b – Vendbanim i hapur në *Gradec* (Koplik). Që në fillim të shekullit arkeologët austriakë, Prashniker e Shober dalluan gjurmë të një vendbanimi romak në fshatin *Gradec* afër Marshejit.

c – Në lagjen *Culaj* të Koplikut është gjetur një kantar i thyer, i lyer me vernik të zi me shkëlqim dhe copëra enësh të tjera të periudhës helenistike. Gjithashtu janë gjetur fragmente enësh ilire me ngjyrë të zezë karbon të shek. VI-V p. k. Rrëzë kodrës së Qytezës në *Zagorë* dhe në Gjyrashë të *Lohes së sipërme* janë gjetur fragmente amforash e enësh tryeze të periudhës urbane (Jubani, 1983; Anamali & Komata, 1978; Prashniker & Shober, 2003; Tafilica, 1988).



### *Bazilika paleokristiane e Lohes*

Kërkimet arkeologjike të kryera më 1989 në Lohe të Sipërme nxorën në dritë rrënojat e një kisha të tipit bazilikal. Ajo është një kishë trinefëshe me formë drejtkëndore, me dimensione 23.20 m x 12.60 m. Është e orientuar në drejtimin lindje-perëndim, me absidën gjysmërrethore kah lindja, e nartekstin nga perëndimi, ku ndodhet edhe hyrja. Muret e saj ruhen përgjithësisht në nivelin e themeleve, nga 0.30 m. deri në 0.60 m. lartësi. Anijadat ndaheshin nga njëra tjetra me harkada me pilastra ose kolona., ndërsa çatia mbulohej me kapriata druri e tjegulla. Kishës i përkasin dy faza ndërtimi. Në fund të shek. IV qe ngritur një kishë më e vogël, muret e së cilës ishin ndërtuar me gurë të latuar kuadratikë, kurse në shek. V ajo ishte rritur, duke iu shtuar narteksti e dy kthina të tjera me mur të bërë me gurë zalli. Gjatë gërmimit u konstatua se objekti ishte ngritur mbi një varrezë më të hershme nga koha e ngritjes së kishës (Tafilica, 1993).

*Gjetje të rastit:* Në këtë rajon janë të shumta artefaktet e gjetura rastësisht në kohë të ndryshme, që i përkasin periudhës helenistike e asaj romake. Ndër to mund të përmendim: Një depo veglash bujqësore gjetur në fshatin Melgushë; fragmente të një mozaiku, ex-voto hyjnish prej mermeri e bronzi nga Trushi; Dy statueta prej bronzi kushtuar Artemidës dhe një kapitël me emrin e hyjneshës Minerva, të gjetura në zonën e Vaudejësit, një kokë sime tempulli nga Ganjolla etj. (Jubani, 1983; Anamali & Komata, 1978; Dibra, 1981).

### *Mesjeta*

*Kalaja e Shurdhahut.* Gjendet mbi bregun e djathtë të Drinit, rreth 8 km. në juglindje të Shkodrës. Më 1970, me formimin e liqenit të një hidrocentrali, kodra e kalasë është kthyer në një ishull të vogël. Gërmimet arkeologjike provuan që fillesat e qytetit vijnë nga periudha romake e vonë. Një moment i parë lulëzimi kanë qenë shekujt 6–8. Me formimin e principatave feudale ai merr fizionominë e një qyteti mesjetar, i ndarë edhe ky në qytetin e poshtëm (*varoshi*) dhe atë të sipërmin (*citadela*), që të dy të mbrojtur me mure rrethuese. Muri i parë ndjek brinjën e kodrinës në pikat pa mbrojtje natyrore dhe rrethon gjithashtu qytetin e poshtëm, që ka të vetmen hyrje në zonën më të ulët, mbrojtur nga dy kulla anësore. Një muraturë e dytë, 370 m. e gjatë rrethon zonën e sipërme të qytetit. Gërmimet kanë nxjerrë në dritë dhe një sërë banesash, ndërmjet të cilave 10 kisha të periudhave të ndryshme të tipit bazilikal. Aty pranë është zbuluar dhe varreza kryesore, me varre të mbuluar me rrasa guri (Spahiu *et al.*, 1974).

*Varreza e Komanit* qe zbuluar mbi një kurriz kodrinor në afërsi të kalasë së Dalmares, pranë fshatit Koman, 15 km. nga Shkodra. Varret janë të ndërtuar dhe të mbuluar prej rrasash guri. Riti i varrimit është ai me vendosje të kadavrës në shpinë, drejtpërdrejt në tokë. Inventari i tyre përbëhet kryesisht prej veglash pune, armësh e stolish prej hekuri, bronzi e argjendi. Kjo kulturë varrezore, e përbërë prej elementësh qartësisht ilirë me ndikime romake e byzantine, duket se i përkiste një komuniteti vendas të shekujve VI-VIII pas k. Ajo qe zbuluar më vonë edhe në vise të tjera brenda e jashtë këtij rajoni, veçanërisht në krahinën e Matit. Mbajtësit

e kësaj kulture, me origjinë prej popullsisë së vjetër ilire, në mesjetën e hershme u quajtën arbën (nga arbanët e përmendur nga Ptolemeu) dhe vend i tyre Arbanon. Tipologjia e varreve, riti i varrimit dhe kultura material janë të njëjtë me ato të qytetit të Shurdhahut (Spahiu, 1979–1980; Anamali, 1979–1980).

### *Kalaja e Shkodrës*

Sipër një kodre shkëmbore ndërmjet Bunës, Drinazës e Kirit ngrihet kalaja mesjetare „Rozafa”. Ngritur mbi ndërtime ilire, formën themelore ajo e ka marrë në gjysmën e dytë të shek. XIV. Muret e brendshme e ndajnë sipërfaqen e saj në tre oborre. Oborri i tretë, i ndodhur në pjesën më të lartë, ruante rolin e një çitadele. Brenda tij ndodhet një kompleks ambientesh, stera uji, tunele të nëndheshme komunikimi si dhe një ndërtesë trekatëshe monumentale, e quajtur „kapitaneria”. Po aty ruhen dhe themelet e pallatit të familjes së Bushatlinjëve, e cila deri më 1856 qe përdorë si banesë e Valiut. Në oborrin e parë, gërmimet arkeologjike të viteve '80, zbuluan rrënojat e një kompleksi banesash të shek. XV. Oborri komunikon drejtpërdrejt me hyrjen kryesore, para së cilës në periudhën veneciane qe ngritur një barbakan, një donzhon i lartë poligonal e mure të tjera mbrojtëse (Karaiskaj, 1981).

*Kalaja e Drishtit* mesjetar (Drivastum) ngrihet mbi një kodër të larte shkëmbore. Muri rrethues i kështjellës së Drishtit zë një sipërfaqe mjaft të madhe. Ai përshkohet nga dy hyrje, njëra nga lindja e tjetra nga perëndimi, ndërsa çitadela sipër prej një hyrjeje të vetme, që përshkon faqen anësore të një kulle drejtkëndëshe. Në kështjellë, që ka formën e një drejtkëndëshi, dallohen disa faza ndërtimi. Të katër kullat e saj shohin nga ana e brendshme e kalasë, pasi muret periferike janë ngritur mbi një humnerë të pangjithëshme. Dy nga kullat janë pajisur me frëngji të vogla për topa. Njëra nga kullat katërkëndëshe, që ka qenë e rrënuar, është rindërtuar në formë ekzistuese, por kësaj rralle me gurë të latuar me kujdes dhe duket se i përket periudhës veneciane (Jubani, 1983; Karaiskaj, 1981; Karaiskaj, 1974).

Në grykën e Drinit e mbi fushë të Zadrimës, ndodhet një kodër me lartësi 204 m sipër së cilës ngrihen muret e *kalasë së Danjës*, brenda së cilës gjinden rrënojat e rezidencës së familjes feudale të Zahariajve. Në dokumentacionin historik mesjetar gjenden vetëm dëshmi indirekte rreth kësaj rezidence, që u zbulua gjatë gërmimeve arkeologjike të viteve 1984–87. Ajo shtrihet në të gjithë sipërfaqen prej 0.2 ha, e kufizuar nga muri i dytë rrethues i qytetit. Selia e Zahariajve, e konceptuar me tri pjesë përbërëse, u ngrit gjatë dy fazave kryesore ndërtimore, që u korrespondojnë faza e dytë dhe e tretë e ndërtimit të sistemit fortifikues të Danjës, pra punimet e bëra rreth viteve 1403 dhe 1458 (Saraçi, 1993).

Në hyrje të luginës së Rrjollit, mbi një kodër të lartë, shquhen muret e *Kalasë së Ballecit*, që rrethojnë një sipërfaqe eliptike me perimetër rreth 800 hapa. Muret që ndodhen pak më poshtë shpatit, midis dushqeve të dendura ruhen në një lartësi prej gati 2.5 m dhe ndiqen në të gjithë gjatësinë e tyre. Në qoshen veriore duken gjurmët e një kulle të rrënuar, në formë trekëndëshi, e cila del 5 m prej murit. Muri mesjetar ndjek konturet natyrore të terrenit. Ai ka një trashësi 1.60 m dhe është ndërtuar prej gurësh të thyer, të vegjël të lidhur me llaç. Nga teknika e ndërtimit ai i ngjanë mure-

ve të kalave mesjetare paraturke në vendin tonë, e ngjashme me atë të kalasë së Danjës (Ippen, 1974).

*Kishat:* Në qytetin e Shkodrës ndodhet kisha e *Shën Shtjefnit* brenda kalasë Rozafa, e shndërruar më pas në xhami; në fshatin Shirq gjenden mbeturinat e kishës kushtuar *Shën Sergjit e Bakut*; në fshatin e Rrashkullës ndodhet kisha e *Shën Gjinit*. Në qytezat e Shurdhahut, Drishtit, Danjës, Ballecit ruhen në gjendje të rrënuar disa kisha mesjetare. Gjurmë kishash njëjefshe ruhen edhe në fshatrat e Kastratit, Shkrelit, Rrjollit, Postribës, Nënshatit, Bregut të Bunës, Anamalit etj. (Tolloczy, 1900; Sirdani, 1930; Valentini, 1936; Ippen, 1900; Jubani, 1983; Tafilica, 2009; Meksi, 1983).

pozita gjeografike, klima dhe resurset natyrore shpjegojnë më së miri lashtësinë, vazhdimësinë dhe densitetin e jetës njerëzore të këtij rajoni, kurse karakteristikat fiziko-gjeografike favorizojnë nga ana tjetër komunikimin me zona të tjera të hapësirës ballkanike dhe asaj adriatiko-mesdhetare. Në këtë kostelacion sitesh e monumentesh arkeologjike që shfaqen në këtë hartë nuk ka se si të mos kenë luajtur një rol parësor pasuria ujore nëntokësore dhe mbitokësore e këtij rajoni, e veçanërisht liqeni, të cilin banorët e lashtë Ilirë e pagëzuan *Lagus Labeatis*.

## LITERATURË

- [1] Anamali, S. & Komata D. 1978. *Varreza e Kalldrunit*, Kumtari, 3–4, Shkodër, 96.
- [2] Anamali, S. 1979–1980. *Antikiteti i vonë dhe mesjeta e hershme në kërkimet shqiptare*, Iliria, 9–10: 5.
- [3] Anamali, S. 1986. *Procese shndërrimi në trevën Jugore ilire në shek. I-IV*, Iliria, 1: 12.
- [4] Anamali, S. 1986. *Procese shndërrimi në trevën Jugore ilire në shek. I-IV*, Iliria, 1: 14.
- [5] Dibra, M. 1981. *Një depo me vegla bujqësore ilire nga fshati Melgushë*, Iliria, 1: 235.
- [6] Fistani, A. 1989. *Gjetje të Paleolitit në afërsi të shpellës së Gajtanit*, Iliria, 1: 5.
- [7] Fistani, F. 1983. *Vendbanimi i fortifikuar ilir i Kratulit*, Iliria, 1: 109.
- [8] Hoxha, G. 1987. *Gjurmë të periudhës së Bronzit të hershëm në kalanë e Shkodrës*, Iliria, 1: 71.
- [9] Hoxha, G. & Lahi, B. 1987. *Gërmime arkeologjike të vitit 1986*, Iliria, 2: 1986, 268 dhe Iliria 2: 252.
- [10] Hoxha, G. 2003. *Scodra dhe Prevalis në antikitetin e vonë*, Shkodër, 46.
- [11] Ippen, Th. 1900. *Alte Kirches und Kirchenruisen in Albanien*, Wienn, 1.
- [12] Ippen, Th. 1900. *Alte Kirches und Kirchenruisen in Albanien*, Wienn, 11.
- [13] Ippen, Th. 1907. *Denkmaler verischiedener Aftersstufen in Albanien*, Wien, 6.
- [14] Islami, S. & Ceka, H. 1965. *Të dhëna të reja mbi lashtësinë ilire në territorin e Shqipërisë*, Konf. I st. alb., Tiranë, 441.
- [15] Islami, S. 1972. *Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri*, Iliria, 2: 7.
- [16] Jubani, B. 1983. *Gërmime arkeologjike të vitit 1983*, Shkrel (Shkodër), Iliria, 2: 248.
- [17] Jubani, B. 1986. *Plotësime për monumentet arkeologjike në Shqipërinë e Veriut*, Monumentet, 1: 123.
- [18] Jubani, B., 1992. *Gërmimet në tumat nr. 2 e 3 të fushës së Shtojit*, Iliria, 1–2: 23.
- [19] Karaiskaj, Gj. 1981. *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë, 148.
- [20] Karaiskaj, Gj. 1978. *Fortifikimi prehistorik i Marshejit*, Iliria, 7–8: 26.
- [21] Karaiskaj, Gj. 1974. *Gjurmë fortifikimesh ilire në disa kështjella të rrethit të Shkodrës*, Buletin Arkeologjik, 4: 150.

- [22] Koka, A. 1990. *Tuma nr. 6 e varrezës së Shtojit*, Iliria, 1: 241.
- [23] Korkuti, M. 1989. *Çështje themelore të Prehistorisë së Shqipërisë*, Iliria, 2: 15.
- [24] Korkuti, M. 1972. *Varreza e Gajtanit*, Iliria, 2: 417.
- [25] Lahi, B. 1988. *Qyteza e fortifikuar e Beltojës*, Iliria, 2: 69.
- [26] Lahi, B. 1988. *Qyteza e fortifikuar e Beltojës*, Iliria, 2: 69.
- [27] Lahi, B. 1993. *Kalaja e Ganjollës*, Iliria, 1–2: 201.
- [28] Lahi, B. 1993. *Kalaja e Ganjollës*, Iliria, 1–2: 201.
- [29] Meksi, A. 1983. *Kisha katedrale e Shën Stefanit në Shkodër*, Monumentet, 2: 80.
- [30] Muzeu Historik i Shkodrës, Fondi arkeologjik.
- [31] Prashniker, K. & Shober, A. 2003. *Kërkime arkeologjike në Shqipëri dhe në Mal të Zi*, Shtëpia Botuese „PEGI”, Tiranë.
- [32] Prendi, F. 1984. *Një depo sëpatash parahistorike nga Torovica e Lezhës*, Iliria, 2: 25.
- [33] Saraçi, Gj. 1993. *Rezidenca e familjes feudale të Zahariajve në Danjë*, Iliria, 1–2: 285.
- [34] Sirdani, M. 1930. *Mbretnesha Helena de Francia e Kisha e Shna Prendes në Shirq*, Hylli i Dritës, Shkodër, 75.
- [35] Spahiu, H. & Komata D. 1974. *Shurdhahu-Sarda, qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar*, Iliria, 3: 257.
- [36] Spahiu, H. 1979–1980. *Varreza arbërore e kalasë së Dalmaces*, Iliria, 9–10: 23.
- [37] Tafilica, Z. 1993. *Bazilika paleokristiane në Lohe të Sipërme*, Kumtari, 6: 43.
- [38] Tafilica, Z. 1988. *Gjurmime arkeologjike në luginën e Prroit të Thatë*, Iliria, 1, Tiranë.
- [39] Tafilica, Z. 2010. *Raport mbi Survein e vitit 2010 në zonën e Postribës*, Arkivi i muzeut Historik të Shkodrës.
- [40] Tafilica, Z. 2009. *Raport mbi Survejin e vitit 2009 në pellgun e Shkodrës*, Arkivi i Muzeut Historik të Shkodrës.
- [41] Tafilica, Z. 2010. *Survey në zonën e Postribës*, Arkivi i Muzeut Historik të Shkodrës.
- [42] Talloçzy, L., *Illyrisch-Albaniscche Forschungen*, I, band, 117.
- [43] Valentini, Z. 1936. *Ma e bukura kishë e moçme shkodrane në kala*, LEKA, Shkodër 274.